



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Uprava za Poleprivredu, Sumarstvo i Ruralni Razvoj

Department of Agriculture, Forestry and Rural Development



# THIRRJE PËR APLIKIM

## Përkrahja e fermerëve me PLEH ARTIFICIAL

Rahovec, Maj 2024

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural fton të gjithë fermerët e Komunës së Rahovecit që të aplikojnë për përfitimin e plehut artificial.

#### Sektorët që do të përkrahen përmes kësaj thirrje janë:

- Të gjithë sektorët përveç kulturave të cilat mbështeten nga MBPZHR me pleh artificial (Gruri, Misri, Patatja dhe Fasulja monokulturë)

#### Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e plehut janë:

- Të jetë banor i Komunës së Rahovecit,
- Të jetë fermerë i regjistruar (NIF)
- Të ketë të shlyera obligimet ndaj Komunës,
- Të jetë kultivues i prodhimeve bujqësore
- Të jetë i gatshëm të nënshkruaj marrëveshje me Komunën e Rahovecit dhe të merr përsipër participimin prej 20%

#### Kriteret specifike që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e plehut janë:

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kriteret specifike:

- Të jetë aplikues i rregullt në Programin e Pagesave Direkte – Subvencione në vitin 2024
- Të ketë së paku **0.10 ha** të mbjellura me kultura bujqësore.

Kategoria	Sipërfaqe ha	Sipërfaqe ha	Thasë (1/25kg)
I	0.10	0.30	2
II	0.31	0.50	3
III	0.51	0.70	4
IV	0.71	0.90	5
V	0.91	1,00	6
VI	1.01	1.50	8
VII	1.51	2.00	10
VIII	2.01	3.00	12
IX	3.01	4.00	14
X	4.01	5.00	16
XI	5.01	6.00	18
XII	6.01	10.00	20
XIII	10,01	-	25

Sqarim: për çdo sipërfaqe e mbjellur në serrë sasia e plehut do të dyfishohet

#### Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacioni (merret online ose në zyrat e DBPZHR-së),
- Kopjen e letërnjoftimit,
- Vërtetim mbi shlyerjen e obligimeve ndaj Komunës së Rahovecit (Tatim në pronë dhe taksë komunale).

**Vërejtje:**

- Përkrahja do të jetë 80% nga Komuna e Rahovecit,
- Të jenë të gatshëm të kryejnë pagesën prej 20%
- Pasi të vlerësohen aplikacionet, të gjithë fermerët do të njoftohen për kohën dhe vendin e furnizimit me pleh.
- Verifikimi i përzgjedhjes së përfitueseve do të bazohet në aplikacionet për Pagesa Direkte të vitit 2024

Afati i aplikimit nga data: **02.05.2024** deri më **22.05.2024**

Aplikacionet dorëzohen në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.



Drejtoria e DBPZHR-së